

PËRKATËSIA GJINORE DHE PJESEMARRJA



Botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Tiranë, Dhjetor 2005

Përgatitja dhe botimi i këtij monitorimi është financuar nga: French Catholic Committee Against Hunger and for Development



FRENCH CATHOLIC COMMITTEE AGAINST HUNGER AND FOR DEVELOPMENT

Përgatiti: Izela Tahsini

Titulli i origjinalit: Gender & Participation. Overview Report by Supriya Akerkar. BRIDGE, Institute of Development Studies, Novemeber 2001.

BRIDGE është themeluar në vitin 1992, si një degë e specializuar mbi përkatësinë gjinore dhe zhvillimin brenda Institutit të Studimeve të Zhvillimit në Mbretërinë e Bashkuar. BRIDGE mbështet iniciativat e politikëbërësve dhe palëve të tjera të interesuara me qëllim integrimin gjinor në fusha të ndryshme.

Botuar në shqip nga:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Kutia postare 2418, Tiranë

Tel. & Fax: (355) 4 255514/5

E-mail: info@gadc-al.org

Këtë botim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

<http://www.gadc-al.org>

Design & Layout: Doralda Muka

Shtypur në shqypshkronjën “PEGI”

ISBN.99943-816-3-6

Përmbajtja

Hyrje	5
Koncepte, modele dhe metodologji	7
Çfarë mund të quajmë pjesëmarrje?	7
Nga “Gratë në Zhvillim” tek “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi”	8
Pse Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi nuk ka qenë më shumë pjesëmarrëse?	9
Pse modelet pjesëmarrëse nuk kanë qenë më të ndjeshme në lidhje me përkatësinë gjinore?	11
Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja: Duke mësuar nga njëri-tjetri	12
Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja në projekte dhe programe	15
Kur projektet pjesëmarrëse e shpërfillnin përkatësinë gjinore	15
Kombinimi i pjesëmarrjes dhe ndjeshmërisë në lidhje me përkatësinë gjinore dhe ndryshime të tjera.	18
Integrimi i përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes në projekte dhe programe	26
Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja në kontekstin e politikave	32
Vlerësimet Pjesëmarrëse të Varfërisë (Participatory Poverty Assessments – PPA)	33
Dokumentat e Strategjive për Reduktimin e Varfërisë (Poverty Reduction	

Strategy Papers- PRSP)	35
Mekanizmat kombëtarë për gratë dhe ndikimi i tyre në proceset e planifikimit	38
Analiza gjinore e buxhetit	39
Mësimet e nxjerra nga këto masa	40
Decentralizimi dhe veprimet afirmative: rritja e pjesëmarrjes së grave në organet dhe proceset vendimarrëse	42
Konkluzione	47
Rekomandime të praktikave pozitive për institucionalizimin e proceseve pjesëmarrëse dhe çështjeve gjinore në nivele të ndryshme	48
Rishikimi i çështjeve gjinore dhe të pjesëmarrjes, tre boshllëqe kritike në njohuri	50

Hyrje

Konceptet “pjesëmarrje” dhe “përkatësi gjinore” kanë qenë pjesë e diskutimit dhe praktikave emancipuese, gjatë dekadës së fundit. Avokatët e këtyre koncepteve kanë thënë se ato lejojnë përfaqësimin e grupeve më të marxhinalizuara – grave dhe të varfërve. Gjithsesi, të dy modelet janë akuzuar se janë dizenuar dhe adresojnë interesat e sektorëve më të marxhinalizuar, përfaqësues të të cilëve deklarohen.

Një gabim i përbashkët i disa aplikimeve të modeleve të përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes është mungesa e ndërgjegjësimit për konfliktet e interesave mes grupeve. Të dyja modelet janë përballur me një grup të ngjashëm pyetjesh nga kritikët, si: Sa mund të marrë parasysh përkatësia gjinore jo vetëm ndryshimet mes burrave dhe grave, por dhe ato mes grave, mes burrave, mes klasave, moshave, etnive, racave, kastave, orientimeve seksuale, etj? Dhe sa e kanë lejuar metodat pjesëmarrëse shprehjen e zërave të ndryshëm brenda përkatësisë gjinore, si dhe të ndryshimeve të tjera? Ngjashmëria e pyetjeve të bëra në të dy rastet ka bërë që personat që i përdorin të dyja modelet, të bëjnë një shënim kritik dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Ky raport hedh një vështrim mbi pikat e takimit mes modeleve të përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes, si janë zbatuar ato, dhe si janë apo mund të ishin integruar në mënyrë konstruktive në projekte, programe, politika dhe institucione. Në seksionin e ardhshëm është dhënë sfondi i koncepteve të përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes, pse nuk ka pasur më shumë ndërveprim në të kaluarën, dhe përpjekjet për të mësuar përmes këtyre dy

¹ BRIDGE falenderon Andrea Cornwall për këshillat e saj dhe redaktimin e këtij raporti.

modeleve. Pjesa e tretë hedh një vështrim mbi përpjekjet për të kombinuar metodologjitë pjesëmarrëse dhe të përkatësisë gjinore në projekte. Pjesa e katërt përshkruan mënyrat sesi të dyja janë përdorur për të ndikuar politikat dhe sa janë institucionalizuar masat e marra. Pjesa e pestë paraqet konkluzionet, rekomandimet për politikat, projektet dhe programet dhe identifikon boshllëqet në kërkime shkencore, në këtë fushë.

Ky raport është pjesë e Paketës më Bashkëkohore mbi Përkatësinë gjinore dhe Pjesëmarrjen, që përmban gjithashtu një kopje të buletinit BRIDGE shkurt, mbi të njëjtën temë dhe një koleksion burimesh mbështetëse.

Konceptet, modelet dhe metodologjitë

Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje?

Pjesëmarrja mund të nënkuptojë shumë gjëra të ndryshme. Në këtë material ne e përdorim pjesëmarrjen për t'iu referuar si përdorimit të metodologjive pjesëmarrëse në projektet e zhvillimit, ashtu dhe pjesëmarrjes në proceset politike qeveritare, etj.

Metodologjitë pjesëmarrëse

Metodologjitë pjesëmarrëse tani përdoren shpesh në projektet e zhvillimit. Ndër ato që njihen më mirë, mund të përmendim Vlerësimin Pjesëmarrës Rural (PRA²), që përdoret gjerësisht për planifikimin e zhvillimit. PRA mbështetet në trashëgiminë e reflektimit kritik të Freire dhe në metoda të tjera të mëparshme pjesëmarrëse të kërkimit, për të zhvilluar një grup praktikash, mjetesh dhe metodologjish, që lehtësojnë reflektimin kritik, analizën dhe veprimin nga grupet e marxhinalizuara. Qëllimi është që banorët vendas të jenë në gjendje të paraqesin dhe analizojnë informacionin mbi jetesën e tyre dhe çështje të tjera, dhe të bëjnë planet e veta. Ky proces të mësuari përforcohet përmes përdorimit të grafikave vizuale dhe mund të motivojë personat e përfshirë – studiuesit, punonjësit e zhvillimit, banorët vendas dhe politikëbërësit të sillen ndryshe dhe të ndër marrin veprime të ndryshme (Guijt dhe Cornwall, 1995; 3).

² Vlerësimi Pjesëmarrës Rural në literaturën përkatëse shqip dhe anglisht, njihet si Participatory Rural Appraisal, ose me inicialet PRA. Kështu do t'i referohemi edhe në këtë material.

E sinqertë apo hipokrizi?

Fjala pjesëmarrje është përdorur me një sërë kuptimesh në projektet e zhvillimit. Dhe pse ajo mund të nënkuptojë qëllimin e sinqertë për të dorëzuar pushtetin për të interpretuar, analizuar dhe për të gjetur zgjidhje, në disa raste, imponimi i axhendave të donatorëve është justifikuar me procese konsultimi sipërfaqësore, të cilat pastaj janë quajtur pjesëmarrëse.

Nga “Gratë në Zhvillim” tek “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi”

8

Që prej viteve '70, përkatësia gjinore është bërë një çështje gjithnjë e më shumë e dukshme në zhvillim. Punonjësit e zhvillimit u ndërgjegjësuan se gratë ishin përjashtuar nga shumë prej përfitimeve të aktiviteteve të zhvillimit. Në përgjigje të kësaj, u bë advokaci për një axhendë “Gratë në Zhvillim” (WID)³, që synonte të rriste përfshirjen e grave vendase në ekonominë e tregut dhe aktivitetet e projekteve. Gjithësesi, problemet me këtë model u bënë të dukshme shpejt. Gratë që më parë punonin shumë, veçanërisht gratë e varfra, dhe puna e grave ishte pjesë e ekonomisë, edhe pse jo domosdoshmërisht e njohur si e tillë, apo e paguar. Rritja e “përfshirjes” së tyre në projekte dhe në treg, ndonjëherë nënkuptonte kryesisht rritjen e ngarkesës së tyre të punës. Për më tepër, modeli WID fokusohej tek gratë pa vëzhguar kontekstin e tyre. Përpjekjet për të ndryshuar situatën e një grupi grash, pa vëzhguar sesi mund të ndikoheshin nga kjo burrat që ishin pjesë e jetës së tyre, çuan në një strategji joefektive. Në vitet '90, “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi” (GAD) u reklamua si modeli i ri që do të kapërcente kufizimet e WID. GAD synon të vëzhgojë marrëdhëniet sociale dhe ndërveprimet mes burrave dhe grave, si dhe kontekstet dhe konstruktionet e

³ Meqënëse si literatura shqip, ashtu dhe ajo e huaj i referohet modelit “Gratë në Zhvillim” me inicialet WID, dhe atij “Përkatësia gjinore dhe Zhvillimi” me inicialet GAD, këto janë inicialet që do të përdorim gjatë këtij materiali për t’u referuar këtyre modeleve.

mashkullores dhe femërores. Deri diku, modeli GAD ka sjellë ndryshime të vërteta, por gjithësesi në praktikë disa ndërhyrje “GAD” mund të vazhdojnë fokusin e shtrembëruar të WID mbi gratë, duke i parë ato të izoluara nga konteksti i tyre.

Tashmë janë zhvilluar një sërë metodash të analizës gjinore si mjete pune të GAD, me qëllim që të aftësohen planifikuesit e zhvillimit, për të kuptuar sistematikisht çështjet gjinore në kontekstin e tyre lokal dhe për të gjetur mënyrat e trajtimit të tyre, në çdo fazë të ciklit të projektit (Mayoux, 1995). Gjithësesi, përkthimi i këtyre metodave të analizës gjinore në mjete praktike pune për të mundësuar reagime dhe strategji rishpërndarëse/transformuese, është më i lehtë për t’u thënë, sesa për t’u bërë. Kërkimi për mjete dhe metoda për të integruar të dhëna dhe praktika të ndjeshme gjinore në projekte dhe politika, nënkupton besimin se teknika mund të triumfojë mbi format e paragjyqimit të rrënjosura në sistemet organizative dhe kulturat e vendit të punës. Paraqitja e përkatësisë gjinore si një çështje teknike, nënvlerëson rolin e modeleve gjinore diskriminuese në sistemet e vlerësimit/motivimit, në strukturat e përgjegjshmërisë, procedurat burokratike dhe praktikat institucionale të organizatave të zhvillimit (Goetz, 1997). Si rezultat, ndryshimet drejt marrëdhënieve më të barabarta gjinore mbeten një qëllim i vazhdueshëm dhe i vështirë për t’u arritur, megjithë

Pse Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi nuk ka qenë më shumë pjesëmarrëse?

Papërshtatshmëria e këtyre metodave për të kuptuar dhe trajtuar realitetet gjinore, tregon nevojën për modele pjesëmarrëse, që sjellin në proces zërat dhe strategjitë e grupeve të ndryshme të interesuara. Një nga arsyet mund të jetë se Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi përfshin aplikimin e modeleve dhe koncepteve të jashtme, si bazë për hartimin ose

vlerësimin e impaktit të ndryshëm të ndërhyrjeve tek gratë dhe burrat. Në kontrast me këtë, modelet pjesëmarrëse që rrjedhin nga shkolla PRA, përpiqen të aftësojnë banorët vendas të artikulojnë dhe analizojnë vetë situatat e tyre, në mënyrën e tyre. Kjo nuk lë shumë hapësirë që lehtësuesit të sfidojnë aspekte të ndryshme të status quo-së, gjë e cila mund të gjejë kundërshtime nga feministet (Cornwall, 2001). Ky konceptualizim nga “lart-poshtë” i përkatësisë gjinore në rrethet e zhvillimit, ka kufizuar hapjen ndaj eksperiencave divergjente, të cilat mund të dalin në pah në aktivitetet pjesëmarrëse. Idetë fikse mbi përkatësinë gjinore nuk përputhen me realitetet komplekse, të ndryshme dhe në ndryshim, të cilat mund të shfaqen në reflektimet pjesëmarrëse mbi përkatësinë gjinore.

Tendencat e mëposhtme kanë penguar që puna mbi përkatësinë gjinore dhe zhvillimin të jetë më pjesëmarrëse:

- Metodat operacionale kanë tendencën t’i trajtojnë burrat dhe gratë sikur ata përbëjnë grupe menjëherë të identifikueshme vetëm prej seksit të tyre, dhe sikur gratë kanë interesa të ndryshme dhe kërkesa konkurruese me ato të burrave. Kjo i izolon burrat dhe gratë nga rrjeti i marrëdhënieve shoqërore, të cilat janë të rëndësishme për mirëqenien e tyre.
- Fokusi tek gratë mund të maskojë forma të tjera përjashtimi dhe ndryshime të tjera brenda kategorisë “grua”. Edhe gratë janë aktive në marrëdhëniet e dominancës dhe të mosprivilegjimit dhe nuk janë domosdoshmërisht më të hapura se burrat ndaj ndarjes së pushtetit dhe kontrollit.
- Marrëdhëniet gjinore përgjithësisht i referohen atij dimensionit të marrëdhënieve mashkull/femër që përfshin marrëdhënie aktuale ose potenciale heteroseksuale. Marrëdhëniet e tjera mashkull-femër, si dhe dimensionet gjinore të marrëdhënieve të të njëjtit seks, zakonisht injorohen (Cornwall, 2001).

Pse modelet pjesëmarrëse nuk kanë qenë më të ndërgjegjshme në lidhje me përkatësinë gjinore?

Ashtu siç ka injoruar pjesëmarrjen puna mbi përkatësinë gjinore, edhe pjesëmarrjes i ka munguar një nivel ndërgjegjësimi mbi përkatësinë gjinore dhe ndryshimet gjinore.

Përkatësia gjinore (në studimet pjesëmarrëse) ishte fshehur në terma që dukeshin si gjithëpërfshirëse: “njerëzit”, “të shtypurit”, ose thjesht “komuniteti”. Vetëm kur u krahasuan... projektet, u bë e qartë se “komuniteti” shumë shpesh nënkuptonte komunitetin mashkullor (Maguire, 1996, cituar në Guijt dhe Shah, 1998:1).

Metodat PRA për shembull, janë në vetvete thellësisht neutrale nga pikëpamja gjinore. Ata lehtësues të PRA, të cilëve ju mungon preokupimi në lidhje me procesin, pushtetin dhe ndryshimet, mund të përforcojnë lehtësisht forma të praktikave të zhvillimit që bëjnë pak për trajtimin e pabarazive. Projekte të shumta, të ashtuquajtura “transformuese”, i kushtojnë pak vëmendje përkatësisë gjinore dhe mbështesin një status quo tepër të pabarabartë. Kjo pjesërisht për shkak të tendencës së PRA për të kërkuar konsensus dhe marrëveshje brenda target grupit, bazuar në idenë shpesh të gabuar se brenda një komuniteti do të gjendet një nivel i caktuar kohezioni dhe interesash të përbashkëta. Në artikullin e saj “Shpëtimi i përkatësisë gjinore nga kurthi i varfërisë”, Cecile Jackson thotë se në modelet pjesëmarrëse, dhe veçanërisht tek PRA, nuk duhet supozuar se gratë mund ose do t’ia shprehin prioritetet e tyre lehtësuesve. Kjo kryesisht pasi ato janë përgjithësisht të përjashtuara nga këndvështrimet dominante të botës dhe fjalorët mashkullorë (Jackson, 1996).

Irene Guijt dhe Meera Kaul Shah kanë identifikuar gjithashtu pengesa tek modelet pjesëmarrëse që trajtojnë përkatësinë gjinore:

- Zhvillimi është drejtuar kryesisht nga një axhendë për lehtësimin e varfërisë. Kjo ka

bërë që analiza e ndryshimeve sociale të kufizohet tek personat mbi dhe nën “nivele të ndryshme”, dhe të mos trajtojë ndryshime si përkatësia gjinore dhe mosha.

- Fillimisht profesionistët e zhvillimit ishin kryesisht burra, gjë që e bënte kulturalisht të vështirë komunikimin me gratë në shumë fusha. Për më tepër, ato përgjithësisht nuk ishin të ekspozuara ndaj analizave gjinore.
- Negocimi i ndryshimeve strukturore me burrat dhe gratë kërkon kohë dhe kurajë, duke u bërë kështu një detyrë jotërheqëse për donatorët dhe për shumë OJF. Asosacioni me një axhendë të imponuar feministe përëndimore - një asosacion i rritur nga presioni i donatorëve – e ka ulur popullaritetin e iniciativave për ndryshime strukturore në marrëdhëniet gjinore (Guijt dhe Shah, 1998).

Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja: duke mësuar nga njëri-tjetri

Deri diku, si profesionistët për pjesëmarrjen, ashtu dhe ata për përkatësinë gjinore, kanë reaguar ndaj kritikizmit të injorancës së tyre të përbashkët, dhe janë gjetur strategji, të cilat i bashkojnë të dy palët.

Modeli transformues ose i fuqizimit për çështjet gjinore lindi në organizatat feministe dhe ato të botës së tretë si DAWN (Development Alternatives for Women in a New Era – Alternativat e Zhvillimit për Gratë në një Erë të Re) dhe theksoi dimensionet kolektive të fuqizimit. DAWN theksoi nevojën për një vizion të ri të zhvillimit, bazuar në perspektivën e grave në vendet në zhvillim, që promovonte ndryshimin drejt një shoqërie të çliruar nga varfëria dhe pabarazia. Metodot bazë ishin mobilizimi politik, ndryshimet ligjore, ndërgjegjësimi dhe arsimi popullor. Kjo pati implikime për strukturat dhe procedurat organizative, si proceset demokratike, dialogun, pjesëmarrjen në politika dhe vendimarrje, si dhe teknikat

për zgjidhjen e konflikteve (Sen dhe Grown, cituar në Oxaal et al., 1997).

Modeli i fuqizimit për çështjet gjinore lidhi pjesëmarrjen dhe zhvillimin në një mënyrë transformuese, për sa kohë që ndryshimi do të drejtohej nga vetëmobilizimi i kolektivit të grave, duke çuar në një proces më të gjerë transformimi social dhe në një sfidë të mundshme ndaj strukturave ekzistuese të pushtetit. Gjithashtu, kjo nënkuptonte lejimin e shfaqjes së interpretimeve konfliktuale të realitetit social brenda komuniteteve-nga gratë dhe burrat nga grupe/klasa të ndryshme sociale. Ideja që qëndronte pas kësaj ishte se lehtësimi i ndjeshëm gjinor do të çonte në një ripozicionim të praktikave sociale. Kjo pastaj nënkuptonte që praktikatat e ndjeshme gjinore të zhvillimit do të duhet të bënin pyetje si ato të bëra nga Robert Chambers në 1997:

- Cilat njohuri vlejné?
- Cilat vlera?
- Cilat kritere dhe preferenca?
- Cilat vlerësime, analiza dhe planifikime?
- Cilat veprime?
- Cilat monitorime dhe vlerësime?
- Të mësuarit e kujt?
- Fuqizimi i kujt?
- Cilat realitete? (Chambers, 1997: 101)

Me fjalë të tjera, fillimi i ndryshimeve të ndjeshme gjinore do të kërkonte shprehi, teknika dhe metodologji, që do të lejonin artikulime të ndryshme, madje dhe konfliktuale të realitetit social brenda komuniteteve dhe do të promovonte angazhimin lokal mbi këto kuptime të ndryshme, për të sjellë ndryshime transformuese gjinore. Projekte të ndryshme sot i janë kthyer përdorimit të metodologjive pjesëmarrëse, për të aftësuar “pronësinë” lokale mbi procese të tilla të ndryshimit social. Zbulimet në thellësi të analizave gjinore, për shembull

nevoja për të dhëna të grupuara sipas gjinisë dhe takime të veçanta për burrat dhe gratë, i kanë pasuruar gjithashtu metodologjitë pjesëmarrëse.

Disa metodologji pjesëmarrëse janë bazuar mbi supozimin se komunitetet janë mjaft homogjene dhe të afta të arrijnë në një konsensus mbi një sërë problemesh dhe zgjidhjesh. Disa modele gjinore supozojnë se gratë kanë një grup interesash të përbashkëta, që janë të ndryshme nga një grup interesash të përbashkëta të burrave. Gjithësesi, tani ekzistojnë shembuj të këtyre modeleve që kanë arritur në përfundimin se e kishin nënvlerësuar diversitetin dhe konfliktin brenda komuniteteve dhe brenda grupeve të grave dhe burrave dhe se vijat ndarëse mund të jenë shumëfishe: etnia, kasta, raca, klasa, kultura, seksualiteti, arsimi, aftësitë fizike, si dhe ndryshimet gjinore, ekonomike dhe shumë faktorë të tjerë. Seksioni i ardhshëm paraqet disa studime rasti të projekteve që dështuan në marrjen parasysh të këtyre interesave shumëfishe dhe pastaj vazhdon me shembuj të atyre që patën sukses në këtë praktikë.

Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja në projekte dhe programe

Aty ku projektet pjesëmarrëse e injoruan përkatësinë gjinore

Projekti i fermave Rainfed Kribhco Indo-Britanik

Ky projekt në Indi, i fokusuar tek varfëria dhe përkatësia gjinore, ka objektivat e ndërtimit të kapaciteteve lokale për të manaxhuar burimet natyrore dhe për të përmirësuar aftësinë e njerëzve më të varfër për të pasur akses ndaj programeve të qeverisë. Në korrik 1992, pas një trainimi të zgjeruar në metodat PRA, organizatorët e komunitetit filluan të hynin në fshatra dhe kryenin PRA.

Të organizuara si ngjarje sociale dhe publike, PRA kishin implikime për llojin e informacionit që u gjenerua. Për shembull, duke qenë fillestare, ato rrallë përfshinë të gjitha seksionet e komunitetit të fshatit: përkatësia gjinore, moshë, farefisnia dhe arsimiti, të gjitha këto ndikuan në natyrën e pjesëmarrjes. Në veçanti, u pa se pjesëmarrja e grave ishte e kufizuar dhe jo në vazhdimësi, pasi gratë përballeshin me një sërë pengesash praktike ndaj pjesëmarrjes, si për shembull koha e kryerjes së PRA, që përplasej me punën e grave në kopshte.

Gratë gjithashtu përballeshin me pengesa sociale, si përjashtimi i tyre kulturor nga hapësirat dhe aktivitetet publike, si ato të lartpërmendura. Shprehjet publike të interesave të grave përgjithësisht kishin të bënin me çështje si kujdesi shëndetësor,

kujdesi për fëmijët, ushqyerja, puna në shtëpi dhe aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave me bazë në shtëpi, dhe si rrjedhim ofronin një profil shoqërisht të pranueshëm të aktiviteteve të grave. Gratë gjithashtu janë të përjashtuara nga vënia në hartë e burimeve natyrore, dhe metodat e përdorura në PRA nuk arritën të përfshinin disa nga preokupimet e grave, si për shembull mbingarkesa me punë dhe dhuna nga bashkëshortët, pasi këto nuk mund të shpreheshin në mënyrë hapësinore, përmes hartave dhe kartave. Për më tepër, si ngjarje publike, PRA theksuan të përgjithshmen kundrejt të veçantës, gjë që çoi në një vështrim të vetëm të interesave, duke anashkaluar ndryshimet dhe konfliktet. Vetë struktura e PRA, që përfshinte aktivitete në grup që çonin në prezantime plenare, supozonte dhe inkurajonte shprehjen e konsensusit (Mosse, 1995).

Projekti i Manaxhimit të Bashkuar të Pyjeve, Indi

Projekti i Manaxhimit të Bashkuar të Pyjeve (MBP) e pati suksesin e tij fillestar falë iniciativës së rojtarëve vendas në Bengal Perëndimor dhe shihet nga disa seksione të profesionistëve të zhvillimit si një alternativë ndaj praktikave tradicionale të manaxhimit të centralizuar të pyjeve në Indi. Mjetet e PRA përdoren për të zhvilluar një plan të manaxhimit të pyjeve të fshatrave. Zakonisht, PRA mbahen në fshat, ku diskutimet organizohen mes grupeve të ndryshme (zakonisht burra, por gjithashtu “disa” gra) mbi historinë, përdorimin e pyjeve dhe problemet e hasura. Një analizë problemesh në PRA theksoi sesi përdorimi i tepruar dhe i pakufizuar i pyjeve kishte çuar drejt degradimit të tyre. Si rrjedhim, përfshiu zgjidhje si rrethimi me gardh i disa zonave për rigjenerim dhe mbjellja e fidanëve të rinj, për të kufizuar aksesin e njerëzve ndaj pyjeve, thjesht për interesat e tyre. Pra, aksesin dhe përdorimin e disa zonave të pyjeve u kufizua në një sërë vendesh ku filloi MBP.

Rrethimi me gardh solli disa pasoja negative tek grupet dhe gratë e varfra, jetesa e të cilëve mbështetej tek pyjet për energji, ushqim dhe nevoja të tjera mbijetese. U zbulua se rrethimi kishte çuar në rritje të punës së grave, veçanërisht të grave të varfra, që mbështeteshin tek pyjet për zjarr. Tani ato duhet të ecnin shumë më gjatë, për shkak të rrethimit të pyjeve më të afërta. Për më tepër, jetesa e burrave dhe të grave që mbështeteshin tek pyjet, shpesh prekej rëndë. Në Projektin e Pyjeve Himachal Pradesh u zbulua se njerëzit shpesh duhet të shisnin dhentë dhe dhitë e tyre, pasi u ndalua kullotja. Familjet që i nxirrnin të ardhurat e tyre nga rritja e dhenve, gjithashtu u prekën rëndë dhe shumë prej tyre tani duhet të gjenin punë në bujqësi. Kjo solli si rrjedhim një ulje të prodhimit bujqësor, pasi plehu i deleve që janë bagëti shumë të mira fushe për plehrim, nuk ishte i disponueshëm (Blunt et al., 1999).

Të dyja eksperiencat tregojnë se kundër qëllimeve të saj, edhe PRA gjithashtu mund të përjetësojë përjashtimin e grave dhe të varfërve. Ndryshimet e dukshme të interesave mes burrave dhe grave, si dhe mes të varfërve dhe të atyre më në gjendje, nënkuptojnë një konflikt potencial. Meqenëse të dyja rastet theksonin konsensusin, dëgjoheshin vetëm zërat dominantë. Si rrjedhim, metodologjitë pjesëmarrëse në vetvete nuk trajtojnë domosdoshmërisht çështjet e pushtetit dhe të të pafuqishmëve brenda komuniteteve. Potenciali transformues ose fuqizues i proceseve pjesëmarrëse të vendosura si objektiva nga PRA, nuk mund të merret si i mirëqenë dhe PRA mund të përdoret për pjesëmarrje nominale (tokenizëm) të grupeve të marxhinalizuara dhe si rrjedhim të përjetësojë dominimin ndaj tyre.

Këto studime rasti nënkuptojnë se pengesat kryesore që hasnin gratë dhe burrat e varfër, për të qenë në gjendje të artikulonin dhe negocionin interesat e tyre, ishin:

- Metodologjitë pjesëmarrëse synonin të fokusoheshin tek “komunitetet”. Gjithësesi

komunitetet nuk janë njësi homogjene me interesa krejtësisht të njëjta. Fokusi tek komunitetet errësoi ndryshimet mes interesave të grupeve sociale si dhe artikullimit të tyre.

- Organizatat lehtësuese dhe vetë individët kishin perceptime paragjyquese të realiteteve të të varfërve dhe grave. Duke mos i kushtuar vëmendjen e përshtatshme procesit të përjashtimit social brenda komuniteteve, ato kontribuan në përjashtimin e shumë zërave nga proceset pjesëmarrëse.

Kombinimi i pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimit për dallimet gjinore dhe ndryshime të tjera

18

Është thelbësore të theksohet se aplikime të tilla të PRA nuk janë modelet e vetme pjesëmarrëse. Janë zhvilluar metoda të tjera për t'iu përgjigjur më mirë ndryshimeve komunitare dhe gjithashtu për të negociuar të drejtat e qytetarëve ndaj shërbimeve të përmirësuara lokale dhe aksesit në institucionet vendimarrëse vendase. Disa organizata janë përpjekur t'i trajtojnë njëanshmëritë në mënyrë sistematike. Ato përfshijnë Redd Barna Uganda, Projekti Rainfed Farming i Indisë Lindore, modeli Stepping Stones në Afrikën e Subsaharës dhe REFLECT në Bangladesh. Eksperiencat e tyre tregojnë se ndihma ndaj organizatave dhe vetë orientimi i personelit të tyre, luajnë një rol të rëndësishëm në çdo proces ndryshimi social.

Redd Barna, Uganda

Redd Barna është një NGO që i ofron mbështetje qeverisë dhe OJF-ve të tjera në përpjekjet planifikuese që do t'u shërbejnë fëmijëve. Në angazhimin e saj për

përdorimin e PRA, Redd Barna gjeti një mungesë të habitshme informacioni mbi dy aspekte thelbësore: së pari, si mund të trajtohen sistematikisht ndryshimet mes komuniteteve dhe e dyta, si mund të përfshihen komunitetet në planifikim, dhe jo vetëm në vlerësim.

Redd Barna e filloi punën e saj në komunitetin Kyakatebe (Rrethi i Masakës), në 1994. Brenda pak muajsh pune me PRA, u finalizua një plan veprimi komunitar dhe filloi zbatimimi. Gjithsesi, rreth 18 muaj më vonë, megjithë rezultatet fillestare pozitive, procesi i planifikimit dhe veprimit komunitar dukej se po pushonte së pulsuari. Një takim komunitar në 1995 në Kyakatebe identifikoi disa arsye për këtë dështim, ku ndër kryesoret ishte: krijimi i të kuptuarit dhe respektit më të thellë për nevojat e ndryshme, përmes proceseve të PRA-së ishte thelbësor.

Në ndryshim nga Kyakatebe, një eksperiment i ri filloi në Bulende-Bugosere në rrethin e Igangës, ku ndryshimet u planifikuan dhe realizuan me grupe më të vogla. Këtu u bënë përpjekje të veçanta për të përfshirë gratë në procesin e planifikimit dhe ato u kërkuan dhe u ftuan hapur për të marrë pjesë. Më shumë vëmendje iu kushtua grave më të reja, për të rritur vetëbesimin e tyre dhe për të nxitur komunitetin që t'i trajtonte me seriozitet. U morën parasysh faktorë të tillë, si orari i takimeve, pasi gratë ishin shpesh të zëna me punët e shtëpisë. Metodave vlerësuese u përshtatën për të punuar me fëmijët, që të ruhej interesi i tyre dhe inputi i tyre të ishte kuptimplotë (Guijt, Kisadha dhe Shah, 1998).

Për një periudhë kohe, RB tashmë zhvilloi një model planifikimi, që ndërton planeveprimi në grup dhe plane veprimi komunitar. Një model me pesë faza merr parasysh dhe lehtëson negociimin e interesave të ndryshme brenda komuniteteve, mes grupeve më të vogla të interesit, si burrat e rinj, gratë e reja, fëmijët, burrat dhe gratë më të moshuara. Çdo grup diskuton dhe analizon situatën e tij, ndërsa lehtësuesit regjistrojnë çështjet

e ngritura në një matricë. “Matrica e Çështjeve” është një tabelë që nënvizon çështjet preokupuese për grupet me interesa të ndryshme. Vetëm pasi grupi ka dalë me një listë çështjesh, bëhet një diskutim i përbashkët dhe ndërmerren veprime të përbashkëta komunitare. Përndryshe, çdo grup vazhdon planet e veta të grupit dhe monitoron zbatimin e tyre. Matrica e Çështjeve është baza për monitorim të mëtejshëm, duke u rinovuar, Matrica prek çështje më të reja dhe seleksionon ato që lidhen më shumë me individë dhe kontekste të ndryshme. Në këtë mënyrë, komunitetet kuptojnë më mirë modelet e tyre të zhvillimit (Mukasa dhe Mugisha, 1999).

Modeli i Stepping Stones

Stepping Stones është një paketë trainimi që është përdorur për të eksploruar mënyra për trajtimin e problemit të HIV/AIDS në Afrikë. Tani është përshtatur për përdorim global. Duke marrë shkas nga fakti se ofrimi i informacionit nuk çon domosdoshmërisht në ndryshime të sjelljes, ky model thekson se është e rëndësishme të fillosh duke u mbështetur mbi perceptimet dhe eksperiencat e vetë njerëzve, në vend që të imponosh të tuat.

Planifikohen një sërë sesionesh, shumica e të cilave i ndajnë individët në grupe bashkëmoshatarësh, sipas moshës dhe përkatësisë gjinore. Një lehtësues me moshë të ngjashme dhe përkatësi gjinore të njëjtë udhëheq çdo grup bashkëmoshatarësh, duke i aftësuar individët të eksplorojnë preokupimet e tyre intime seksuale dhe çështje të tjera delikate. Sesionet gjithashtu fokusohen në trainimin asertiv dhe inkurajojnë çdo grup bashkëmoshatarësh të marrin parasysh dhe të aplikojnë mënyra për ndryshimin e sjelljes së tyre dhe për t’u përgatitur për të ardhmen.

Në grupet e bashkëmoshatarëve, pjesëmarrësit kanë kohë dhe hapësirë për të punuar së bashku dhe për të vendosur vetë zgjidhjet më të mira për sfidat që përballojnë. Kjo ndihmon për zhvillimin e identitetit të grupit dhe të rregullave të grupit për bashkëveprim. Takimet e grupeve të bashkëmoshatarëve përzihen me sesione mikse, ky çdo grup prezanton idetë e veta dhe nxiten diskutimet për ngjashmëritë, ndryshimet dhe zgjidhjet. Kjo strukturë rrit ndërgjegjësimin për nevojat dhe shqetësimet e anëtarëve të tjerë në komunitet. Kështu i gjithë procesi aftëson individët, grupet e bashkëmoshatarëve dhe komunitetet të eksplorojnë nevojat e veta sociale, seksuale dhe psikologjike. Pjesëmarrësit janë të aftë të analizojnë pengesat që ndeshin në komunikim dhe të praktikojnë mënyra të ndryshme për të trajtuar marrëdhëniet e tyre. Lehtësuesit nxisin çdo grup bashkëmoshatarësh që të vazhdojnë të takohen rregullisht, edhe pas sesionit të fundit.

Zhvillimi afatgjatë i grupeve të tilla të vetëndihmës ka qenë kyç, për të pasur ndryshime të qëndrueshme në sjellje. Diskutimet në fshatin Buweda të Ugandës sugjerojnë se ky model ka çuar në:

- Ndryshime të sjelljes, si: më pak grindje mes çifteve dhe ndarje të shpenzimeve të familjes.
- Respekt më të madh reciprok mes grave dhe burrave të rinj.
- Rritje e aftësive për të diskutuar çështjet seksuale me fëmijët.
- Rritje të qëndrueshme në përdorimin e prezervativëve (Welbourn, 1998).

Projekti i Fermave Rainfed i Indisë Lindore

Ky Projekt punon kryesisht në zonat e fiseve të Indisë Lindore. Qëllimi kryesor i tij është të përmirësojë jetesën e grave dhe burrave përmes planifikimit pjesëmarrës dhe zhvillimit të sistemit të fermave, ndërtimit të institucioneve dhe gjenerimit të të ardhurave. Strategjia e projektit kundër varfërisë ka qenë identifikimi i familjeve më të varfra, ose “BLAD” (njerëzit që jetojnë mes jetës dhe vdekjes) dhe familjeve në deficit (familje që nuk kanë ushqim të mjaftueshëm gjatë vitit). Në vite, projekti ka zhvilluar një kuptim më të detajuar të varfërisë dhe çështjeve të jetesës dhe pengesave, përmes shkallëzimit pjesëmarrës të varfërisë.

Në shkallëzimin pjesëmarrës të varfërisë, banorët identifikojnë rreth pesë kategori të mirëqenies brenda fshatit. Kategoria e pestë dhe më e ulëta është ajo e personave shumë të varfër. Kjo përfshin ata që janë të moshuar, të sëmurë mendorë ose me vështirësi fizike, ata pa mbështetje familjare, ata me probleme të rënda alkolizmi, gratë e veja me fëmijë të vegjël dhe pa mbështetje familjare, personat që jetojnë periudha të gjatë sëmundjeje dhe ata që lypin në fshat. Strategjia e përgjithshme e projektit ka qenë ndërmarrja e ndërhyrjeve zhvillimore, së pari përmes PRA dhe së dyti përmes zbatimit të gjenerimit të të ardhurave dhe alternativave të sistemeve të fermave, duke përdorur grupe të vetëndihmës për familjet e varfra.

Gjithësesi, projekti fillimisht nuk ishte në gjendje të përfshinte “BLAD” në PRA, në proceset pjesëmarrëse dhe grupet e vetëndihmës. Personat BLAD nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në takimet e planifikimit, për shkak të pengesave të tilla si moshja e madhe dhe sëmundjet, ose pa aftësi të tjera. Gjithësesi, projekti tani bën vlerësime “individuale” të nevojave të personave të tillë vulnerabël, duke përfshirë grupet ekzistuese të vetëndihmës në fshatra. Këto grupe janë të përfshirë në gjetjen e alternativave për të nxjerrë personat BLAD nga izolimi social. Kjo ka çuar në mikro-

alternativanovatore, për shembull në një sistem ku një grant projekti që i është dhënë një anëtari BLAD, investohet nga grupet e vetëndihmës si kredi për anëtarët e vet. Interesi mujor i jepet personit BLAD, si një burim të ardhurash. Grupet e vetëndihmës nxiten të monitorojnë mirëqenien e personave të tillë dhe të eksplorojnë një strategji përkujdesjeje për ta (Akerkar, 2000a).

Mësimet e nxjerra

Nga këto tre eksperiencia me metodologjitë pjesëmarrëse diçka duket shumë qartë: pjesëmarrja nuk është një proces i hapur dhe spontan, përmes të cilit të gjithë marrin pjesë në mënyrë të barabartë, duke çuar në një “konsensus të lirë” mbi çështjet në diskutim. Ajo ngjan më shumë me “një proces kompleks politik, në të cilin pabarazitë në burime dhe pushtet mes pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësve të mundshëm ndikojnë fuqishëm qëllimet e pjesëmarrjes dhe format që merr ajo” (Mayoux, 1995:245). Vendimi se cilat nga nevojat e shumta dhe konfliktuale do të trajtohen, është tepër kompleks dhe nuk mund të ndahet nga shqetësimet më të gjera politike.

Praktikat më të mira, të dala nga pesë eksperiencat e mësipërme janë:

Ndërgjegjësimi se si “pjesëmarrja” ashtu dhe “përkatësia gjinore” janë çështje politike, dhe se bërja e pjesëmarrjes të ndjeshme në lidhje me përkatësinë gjinore është një proces politik.

- Studimet e rasteve nisen nga fakti se komunitetet janë heterogjene, se ekzistojnë kuptime dhe eksperiencia të ndryshme dhe madje konfliktuale mbi të njëjtën çështje, mes grupeve të ndryshme sociale. Këto modele vënë në pikëpyetje disa koncepte, veçanërisht të përbashkëtat gjinore dhe interesat e përbashkëta komunitare, kuptimet dhe zgjidhjet. Ato lejojnë ndryshimet në perceptime dhe eksperiencia mes burrave

dhe grave, grave dhe grave dhe mes personave nga grupe të ndryshme moshe, statusi martesor dhe përbërjeje sociale.

- Lehtësuesit punojnë me besimin se përcaktimi i prioriteteve, negociimi i proceseve të ndryshimit dhe veprimi në lidhje me to çon në ndryshim të marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme sociale dhe aftësive të tyre për të ndikuar njëri-tjetrin. Në veçanti, një proces i tillë fuqizon grupet e marxhinalizuara, duke i aftësuar ato të marrin pjesë në proceset e reflektimit, analizës, marrëveshjes dhe kontestimit. Kjo përcakton procesin e ndihmës, duke rritur ndikimin e personave të marxhinalizuar. Pikërisht përmes këtij procesi mund të ndodhin ndryshime transformuese gjinore.

Pranimi i faktit se është nevoja për strategji, për të nxjerrë në pah zëra të ndryshëm

- Teknikat pjesëmarrëse përdoren në diskutime në grupe të bashkëmoshatarëve, të veçanta për gratë, burrat dhe për grupe të tjera sipas moshës, statusit martesor dhe përbërjes sociale, nëse është e nevojshme.
- Vëmendje e veçantë i jepet strukturave pjesëmarrëse: për shembull, vendndodhja dhe koha e kryerjes së takimeve dhe kriteret për anëtarësim, që mundësojnë pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme sociale.
- Përfshirja e sesioneve për burrat dhe gratë së bashku identifikon rolin kyç të të gjithë anëtarëve të komunitetit në rritjen e nivelit të pjesëmarrjes dhe lehtëson presionin mbi gratë, për të qenë anëtare të vetme të ndryshimit.
- Përfshihen anëtarë të ndryshëm të komunitetit dhe përdoren një sërë reagimesh dhe vendndodhjesh strategjike. Fuqizimi duhet të jetë shumëplanësh, në vend që të fokusohet vetëm në një aspekt të jetës së grave.

Manaxhimi i ndryshimit, pushtetit dhe konfliktit

- Lehtësuesit mbeten të ndërgjegjshëm se pjesëmarrja dhe të punuarit me ndryshimet

janë procese që kërkojnë kohë dhe nuk mund të arrihen përmes takimeve të shkurtra dhe të shpejta.

- përjashtimit, kur vendosin se cilat çështje të trajtojnë. Ata njohin diferencat në pushtet, që janë pjesë e çdo marrëdhënieje sociale dhe mbeten të vëmendshëm ndaj ndikimit të tyre në proceset e ndryshimit.
- Lehtësuesit sigurojnë një platformë, që grupet e ndryshme sociale të ndajnë eksperiencat, të artikulojnë shqetësimet e tyre, të përcaktojnë prioritetet dhe për të bërë zgjedhje ndër alternativat e mundshme. Çështjet e artikuluara përfshijnë një gamë të gjerë marrëdhëniesh sociale të personave/grupeve në lidhje me familjen, komunitetin, tregun dhe shtetin.
- Lehtësuesit në mënyrë të ndërgjegjshme arbitrojnë konfliktet dhe ndryshimet dhe aftësojnë grupet të zhvillojnë planin e tyre të veprimit. Ndërkohë që arrihet konsensus me bazë të gjerë mes të gjitha grupeve sociale mbi disa çështje, ata pranojnë se kjo nuk është e mundur gjithmonë.
- Lehtësuesit aftësojnë pjesëmarrësit të realizojnë planet e tyre të veprimit. Pjesëmarrësit monitorojnë progresin e tyre në lidhje me planin e veprimit dhe sipas kësaj drejtojnë procesin e ndryshimit.

Kufizimet

Eksperiencat dhe studimet e rastit si Stepping Stones dhe Redd Barna, Uganda kanë zhvilluar metodologji që nxisin artikulime të ndryshme sipas akteve të ndryshimeve si përkatësia gjinore, moshë, klani/kasta. Gjithësesi, në lidhje me çështjet si klasa dhe veçanërisht aftësitë e kufizuara ende ka vështirësi dhe përpjekje nga organizata si Redd Barna, Uganda. Një nga personat që punojnë aty ka vënë në dukje se megjithë përpjekjet e tyre, është mjaft e vështirë të preken më të varfërit, që shpesh janë gjithashtu me aftësi të kufizuara, të moshuar dhe të sëmurë. Sesi mund të zgjidhet kjo, është ende e paqartë (Guijt, Kisadha dhe Mukasa, 1998).

Studimi i rastit i Indisë Lindore tregon një rrugë të rëndësishme për të ecur përpara në lidhje me këto çështje. Strategjia e nxjerrjes së njerëzve më të varfër nga izolimi dhe përjashtimi social, duke ndërtuar marrëdhënie të ndërgjegjshme mes familjeve të varfra dhe pjesës tjetër të komunitetit, ka qenë themeli bazë, mbi të cilin janë eksploruar alternativa të mëtejshme jetese për personat BLAD. Rasti i Indisë Lindore ka si target antarët vulnerabël të komunitetit veçmas, si dhe integrimin e tyre në procese më të gjera komunitare. Kjo ka qenë kyçe për ndryshimin e imazhit për veten dhe të statusit të personave BLAD brenda komunitetit. Gjithësesi, ekziston nevoja për më shumë studime mbi mënyrat sesi mund të artikuloen siç duhet zërat e ndryshëm që shfaqen përgjatë akteve shumëfishe të ndryshimeve si kasta,

26 Integrimi i përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes në projekte dhe programe

Një integrim i vërtetë i përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes në projekte dhe programe është i nevojshëm të kryhet në çdo fazë të ciklit të projektit. I tërë cikli, që nga planifikimi pjesëmarrës tek zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi, filtron informacionin në nivele të ndryshme për të arritur në thellësi të reja, për veprime të mëtejshme. Për çfarëdo integrimi të proceseve gjinore dhe pjesëmarrëse është kyçe çështja se kush kontrollon procesin e mbledhjes dhe analizës së informacionit, dhe kërkimin e zgjidhjeve. Të dhënat, përveç zbërthimit sipas përkatësisë gjinore, duhet të procesohen në një mënyrë që ekspozon dhe shpjegon ndërlidhjet mes çështjeve dhe arrin në konkluzione të ndërgjegjshme, të cilat futen në strategjinë e projektit. Çështje më të mëdha duhen ngritur mbi faktin se kush mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat. Nëse nuk ekziston një analizë kritike e dinamikave gjinore, atëherë ekziston rreziku se burrat dhe gratë do të përfaqësohen si të izoluar nga rrjeti i marrëdhënieve sociale që ndikojnë në mirëqenien e tyre.

Proceset reflektuese, analiza dhe veprimi social nga grupe të ndryshme të komunitetit, duhet të jenë thelbi i strategjisë së përgjithshme të pjesëmarrjes. Kjo ka bërë që shumë të pranojnë se një strategji për ndryshimin institucional është një përbërës i nevojshëm i çdo procesi ndryshimi. Gjithësesi, institucionalizimi i këtyre elementëve përta i përket praktikës konkrete, nuk është i lehtë, duke pasur parasysh praninë e kaq shumë palëve të interesuara dhe interesave të tyre gjinore të ndryshme, madje dhe konfliktuale. Ndërsa pengesat dhe mundësitë institucionale kufizojnë integrimin e përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrjes në të gjitha aspektet e projektit, ekzistojnë disa shembuj inkurajues. Karakteristikat e përpjekjeve për një integrim më të suksesshëm përfshijnë:

Integrimin e ndërgjegjshëm të njohurive dhe veprimit social, duke theksuar të drejtat

Një model i mbështetur tek të drejtat mbështetet tek ideja se për të rritur pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje, gratë duhet të jenë të ndërgjegjshme për të drejtat e tyre njerëzore dhe t'i ushtrojnë ato. Një model i tillë pranon se:

- Të drejtat janë kërkesa të ligjshme të grave, siç përcaktohet në konventat ndërkombëtare të njohura nga qeveritë.
- Barazia mes burrave dhe grave është baza mbi të cilën diskutohet për ndryshim
- Nevojat praktike dhe strategjike gjinore shpesh ngatërrohen. Një kërkesë për një nevojë praktike mund të çojë në një zhvendosje strategjike të pushtetit. Për shembull, kërkesa për kujdes më të mirë shëndetësor ose ujë të pijshëm mund të rrisë statusin e gruas.
- Edukimi mbi të drejtat mund të çojë në kërkesa për reforma ligjore, zbatim më të mirë të ligjeve ekzistuese dhe ndryshime në politika.
- Të drejtat ekonomike, sociale, civile dhe politike kanë status të barabartë. Kjo mund të jetë e rëndësishme. Për shembull, shpërndarja e të ardhurave brenda familjes, që është e nevojshme për të rritur të ardhurat e të gjithë familjes, i përfshin të gjitha këto të drejta (përshtatur nga Long dhe Phillips, 2000).

Modelet e bazuar tek të drejtat zakonisht funksionojnë nga lart-poshtë, përmes ndryshimeve legislative dhe ndërgjegjësimit të njerëzve për të drejtat e tyre. Një model ndërgjegjësues funksionon nga poshtë-lart, duke i aftësuar njerëzit të ndërgjegjësohen për potencialin e tyre për të ndryshuar situatat ku ndodhin. Shumë shpesh, këto modele nuk janë të lidhura, dhe aktivistët e të drejtave punojnë në një nivel, ndërsa aktivistët e fuqizimit/ndërgjegjësimit në një nivel tjetër. Gjithësesi, ata po fillojnë të bashkohen. Duke u fokusuar tek analfabetizmi dhe aksionet sociale, modeli REFLECT, i zhvilluar nga Actionaid, ofron një metodë për të kombinuar të dy modelet.

Modeli REFLECT për analfabetizmin dhe ndryshimin social

Modeli REFLECT (Regenerated Freirean Literacy through Empowering Community Techniques – Shkrim e leximi Freiran përmes teknikave fuqizuese komunitare) është shembulli i një modeli bazuar tek të drejtat, ku njohuritë dhe aksioni social janë të ndërlidhura. REFLECT bazohet në filozofinë e Paulo Freire, dhe përdor teknika si PRA, që stimulojnë shkëmbimin e njohurive të pjesëmarrësve, analizimin e temave me interes lokal dhe ndërmarrjen e veprimeve individuale ose kolektive, sipas nevojës.

Roli i mësuesit ose “lehtësuesit” në një orë REFLECT (që quhet rreth), është që të lehtësojë këtë diskutim. Kjo përfshin eksplorimin në thellësi në marrëdhëniet mes strukturave të pushtetit, shtresëzimit social dhe në temat specifike me interes për grupin, si dhe prezantimin e shprehive të shkrimit, leximit dhe numërimit, përmes diskutimeve të tilla.

Në këtë mënyrë REFLECT përpiqet të thyejë lidhjen mes analfabetizmit, varfërisë, marginalizimit dhe diskriminimit. Diskutimet shpesh nisnin nga analiza lokale, por kjo lidhet edhe me çështje më të gjera kombëtare dhe globale. Rasti i REFLECT tregon

se mjete të tilla si vëzhgimi i pjesëmarrësve, janë shumë me vlerë për të kuptuar mundësitë kulturalisht specifike për të sjellë ndryshim. Kjo si rrjedhojë ndihmon lehtësuesit të zhvillojnë një grup pyetjesh, që janë të përshtatura me çështjet dhe situatat vendase.

REFLECT Nikaragua

Në Nikaragua, Grupo Venancia i OJF-ve ka zhvilluar metodologjinë e vet REFLECT, për t'u siguruar që gratë pjesëmarrëse në rrethet e shkrimit dhe leximit të eksplorojnë sesi marrëdhëniet e pabarabarta gjinore ndikojnë në jetët e tyre dhe sesi mund t'i trajtojnë pabarazitë. Puna mbi shprehjet e shkrimit dhe leximit është e kombinuar me një eksplorim të njohurive dhe eksperiencave të grave, identifikimin e nevojave të përbashkëta dhe veprimeve të përshtatshme social

Rinovimin e vazhdueshëm të metodave pjesëmarrëse për të kuptuar më mirë aspektet e marrëdhënieve sociale, veçanërisht atyre gjinore.

Në një grup në Sierra Leone, kur u kërkua që të vizatoheshin përmirësimet e dëshiruara, disa gra u përgjigjën “Ne nuk mund të vizatojmë ndryshime në këtë hartë, pasi llojet e ndryshimeve që na nevojiten nuk mund të vizatohen”. Ata po ju referoheshin çështjeve të tilla si mbingarkesa e punës, mungesa e mbështetjes dhe rrahja nga bashkëshortët, që nuk mund të vizatoheshin përmes teknikave vizuale PRA (Welbourn, 1991). Leksionet në metodologji, nga Redd Barna Uganda, India Lindore dhe Stepping Stones janë të rëndësishme në këtë rast. Përgjithësisht është pranuar se jo të gjitha nevojat dhe interesat e burrave dhe të grave mund të prezantohen përmes teknikave hapësinore (për shembull, përmes hartave dhe matricave) dhe se mjetet duhet të përshtaten vazhdimisht, për t'u përshtatur kontekstit ku përdoren.

Pranimin e vështirësive të gjuhës dhe përkthimit

Gjuha mund të jetë pengesë për një analizë, monitorim dhe vlerësim të mirë, nëse nuk pranohet vështirësia e përkthimit të koncepteve. Shumë projekte të financuara nga donatorët përdorin terminologji që reflekton treguesit e ndryshimit social në gjuhën angleze. Gjithësesi, jo të gjitha konceptet në anglisht kanë të njëjtin kuptim në gjuhët lokale. Në situata të tilla, monitorimi dhe vlerësimi i pjesëmarrësve ka nevojë për një rradhitje të kujdesshme të pyetjeve që përdorin koncepte dhe shprehje lokale, për të kuptuar perceptimet e njerëzve mbi ndryshimin. Ndryshimi brenda një vendi specifik ka nevojë për vëmendje të veçantë dhe nuk mund t'i atribuohet në mënyrë të supozuar një projekti të veçantë.

30

Projekti i fermave Rainfed i Indisë Lindore

Ky projekt është një shembull i përdorimit të koncepteve vendase në vlerësimet pjesëmarrëse dhe në trajtimin e çështjeve të atribuimit. Një përbërës i punës së impaktit të projektit është të kuptuarit e ndjenjave të fuqizimit të grave, dhe sesa efekt ka pasur projekti mbi këto. Në këtë rast, nuk ekzistonte një ekuivalent vendas për konceptin e fuqizimit dhe në pyetje u desh të përdoshin disa fjali ekuivalente. Këto u testuan me gra të komuniteteve/grupeve sociale të ndryshme, për të parë nëse ishin kuptuar në të

njëjtën mënyrë nga të gjithë. Testimi i fjalive dhe shprehjeve të ndryshme ka çfuar tani në përdorimin e një grupi me katër fjali me fund të hapur, me fjalë të renditura me kujdes, të cilat i lejojnë gratë të flasnin për mënyrat e ndryshme sesi ndiejnë fuqizimin apo mungesën e fuqizimit. Për shembull, “Në cilat situata ndiheni pa shpresë, vulnerabël ose të pafuqishëm?” (Ekuivalenti indian për të treja këto fjalë në anglisht është “lachaar”. Kjo fjali e vetme arriti të kapte një sërë dimensionesh që i përkisnin jetëve të grave).

Së dyti, çështja e atribuimit të ndryshimeve në situatën e grave trajtohet me kujdes, duke bërë pyetje të lidhura me impaktin, në fjali të renditura me kujdes. Për shembull, gratë fillimisht ftohen të flasin për ndryshime në situatën e tyre, ku janë ndier të pafuqishme, pa iu referuar projektit. Vetëm pas këtyre diskutimeve është e mundur të pyeten gratë nëse projekti ka qenë përgjegjës për ndonjë nga ndryshimet që kanë përjetuar (Akerkar, 2000b; Ladbury, 2000).

Integrimi gjinor si pjesë e përshtatjes së institucioneve

Përkushtimi ndaj punë për të arritur barazinë gjinore nuk mund të ndalet vetëm me një shqyrtim të marrëdhënieve mes personelit të agjencive dhe përfituesve. Lehtësuesit dhe promovuesit kanë nevojë të shqyrtojnë jetën e tyre nga një perspektivë gjinore. Kjo do të përfshinte gjithashtu një analizë të mënyrës sesi punojnë agjencitë dhe gjithashtu edhe marrëdhëniet personale dhe profesionale të personelit. Për më tepër, nevojitet një proces i vazhdueshëm mbështetjeje për personelin, për t'u siguruar që ata të jenë në kontakt me idetë e reja dhe novacionet e gjeneruara në vendet e tjera, në mënyrë që të mund të ndajnë eksperiencat dhe problemet e tyre.

Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja në kontekstin e politikave

Gjatë njëzet vjetëve të fundit, koncepti i pjesëmarrjes është përdorur gjerësisht në zhvillim, duke iu referuar kryesisht pjesëmarrjes në projekte ose në komunitet. Tani proceset e përfshirjes dhe reflektimit kritik, të nxitura nga metodat pjesëmarrëse, janë përfshirë në debatin për një qeverisje të mirë (Cornwall, 2001; Goetz and Gaventa, 2001). “Pjesëmarrja tani po lidhet me të drejtat e qytetarisë dhe me qeverisjen demokratike” (Faqja e IDS në internet: www.ids.ac.uk/ids/particip/research/localgov.html). Kjo reflektohet nga njëra anë në decentralizimin e proceseve politike në vende, dhe nga ana tjetër në përpjekjet për të ofruar një platformë për dialogun në nivel politikash. Një dialog i tillë mes shoqërisë civile dhe shtetit konsiderohet i rëndësishëm për të formuluar politika që kanë në qendër njerëzit. Gjithashtu, forumet ndërqeveritare të drejtuara nga Kombet e Bashkuara, si Konferenca e Katërt Botërore për Gratë në Pekin, e kanë theksuar një dialog të tillë. Arritja e skemave të politikave të ndjeshme në lidhje me përkatësinë gjinore kërkon zhvillimin e proceseve pjesëmarrëse me segmentet e shoqërisë civile që përfaqësojnë shqetësimet gjinore.

Ky nënseksion eksploron se në çfarë shkalle janë përdorur proceset politike për të integruar pjesëmarrjen dhe përkatësinë gjinore në politika. Së pari do të vëzhgojë Vlerësimet Pjesëmarrëse të Varfërisë (Participatory Poverty Assessments – PPA) dhe dokumentat e Strategjive për Reduktimin e Varfërisë (Poverty Reduction Strategy Papers- PRSP)⁴ të udhëhequra nga Banka Botërore, si shembuj të përpjekjeve për të përfshirë pjesëmarrjen në proceset e politikëbërjes. Së dyti do të vëzhgojë sesi disa vende janë përpjekur të integrojnë

⁴ Vlerësimi Pjesëmarrës i Varfërisë në literaturën përkatëse shqip dhe anglisht, njihet si Participatory Poverty Assessment, ose me inicialet PPA. Gjithashtu, dokumentat e Strategjive për Reduktimin e Varfërisë njihen si Poverty Reduction Strategy Papers, ose me inicialet PRSP. Kështu do t'i referohemi edhe në këtë material.

përkatësinë gjinore në proceset e politikave, përmes krijimit të “mekanizmave kombëtare”, si njësitë e grave dhe mekanizmat e advokacisë. Së treti, do të tregojë sesi analiza gjinore e buxheteve ka punuar drejt ndryshimeve rishpërndarëse në nivel kombëtar. A e kanë kombinuar këto masa integrimin gjinor në politikat kombëtare me proceset pjesëmarrëse, apo kanë mbetur të veçuara? Çfarë mund të mësohet për të formuluar praktika më të mira për të integruar përkatësinë gjinore dhe proceset pjesëmarrëse në hartimin e politikave?

Në fund, nënseksioni do të japë disa shembuj të mënyrave sesi qeveritë janë përpjekur të institucionalizojnë përkatësinë gjinore dhe pjesëmarrjen në proceset më të përgjithshme të politikave dhe në strukturat politike, për shembull përmes veprimeve afirmative dhe decentralizimit.

Vlerësimet Pjesëmarrëse të Varfërisë (Participatory Poverty Assessments-PPA)

Modelet pjesëmarrëse e kanë zgjeruar kuptimin tonë mbi atë ç’ka është varfëria, dhe nëse janë të suksesshme, tregojnë sesi ndikojnë marrëdhëniet gjinore në vulnerabilitetin e burrave dhe grave ndaj varfërisë, dhe si mund të dalin ata nga kjo gjendje. PPA dhe PRSP përfaqësojnë përpjekjet për ta përfshirë këtë kuptim në politika, si dhe për të nxitur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikëbërje. Në vitet ’90, Banka Botërore kreu Vlerësimet e Varfërisë (Poverty Assessments-PA) në më shumë se 50 vende. Përveç analizës sasiore, disa PA përdorën edhe metodologjitë PPA. Kjo kombinoi metodat cilësore si fokus grupet, intervistat gjysmë të strukturuar, intervistat në formë bisede, me teknikat PPA të vlerësimit pjesëmarrës rural, si diagramat venn dhe shkallëzimi i pasurisë. Raporti kryesor PA në raste të tilla ishte një rezultat i përdorimit të metodave pjesëmarrëse, të kombinuara me metoda të tjera konvencionale të mbledhjes së të dhënave.

Gjithësesi, një analizë e procesit në disa vende, nga Whitehead dhe Lockwood tregon se ndonëse shumë PPA prodhuan shembuj interesantë mbi çështjet e përkatësisë gjinore, teksti kryesor PA nuk i integron këto gjetje në rekomandimet e politikave.

- PA u orientuan sipas të dhënave të ndara sipas seksit, pa analizë të përshtatshme gjinore, ose ishin rezultat i leximeve përzgjedhëse të gjetjeve të PPA. Kjo çoi në rekomandime të thjeshtëzuara për ndryshime (shihni për shembull, PPA e Zambias dhe raportin kryesor të saj PA, si dhe atë të Gana II).
- Manuali për Reduktimin e Varfërisë i Bankës Botërore dhe politikat e përcaktuara nga Raporti Botëror i Zhvillimit i vitit 1990, kanë përcaktuar gjerësisht gjetjet e PA. Për shembull, implikimet gjinore në tre fusha të PA përputhen me modelin e Raportit Botëror të Zhvillimit, pikërisht rritja e orientuar drejt tregut, rritja bujqësore e orientuar drejt eksportit dhe roli i arsimit dhe vulnerabiliteti.
- Pak vëmendje i është kushtuar detajeve empirike të matjes së varfërisë dhe analizës të dalë nga PPA, që tregon ndikimin e modelit të Raportit të vitit 1990 në tekstin e PA.

Këto shembuj ilustronë “filtrimin jashtë” PA të çështjeve gjinore të PPA, dhe nga mbledhja kryesore dhe analiza e të dhënave në formulimin e politikave. Kur arrihet në kapitullin e politikave në shumë PA, shpesh gratë e varfra dhe karakteristikat e tyre specifike janë zhdukur. Edhe aty ku pjesa kryesore e PA i ka trajtuar çështjet gjinore, ekziston një hendek thelbësor mes këtyre diskutimeve dhe mënyrës sesi përkatësia gjinore trajtohet në seksionet finale të politikave të raportit (Whitehead dhe Lockwood, 1999).

PPA në Afrikën e Jugut dhe Xhamajkë

PPA e Afrikës së Jugut dhe Xhamajkës shkuan përtej të mëparshmeve në informimin mbi eksperiencat e grave brenda marrëdhënieve heteroseksuale. Skuadra përfshinte

studiuës dhe punonjës OJF-sh feministë, që siguruan që interesat e grave të mbeteshin në axhendë përmes sintezës, analizës dhe shkrimit të politikave, si dhe ftuan të angazhoheshin aktorët që mund ta realizonin këtë (Cornwall, 200). Gjithsesi, meqenëse ata nuk arritën të përfshinin eksperiencat gjinore të burrave, kjo i ngjau më tepër një perspektive të fokusuar tek gratë, sesa një perspektive gjinore të balancuar.

Dokumentat e Strategjive për Reduktimin e Varfërisë

Pas kritikizmit ndaj politikave të saj të përshtatjes strukturore dhe ndikimit të tyre tek të varfërit, Banka Botërore gjatë pesë viteve të fundit ka filluar një iniciativë të re për vendet e varfëra me borxhe të rënda. Qeverive të këtyre vendeve iu kërkohet të zhvillojnë një dokument strategjie për reduktimin e varfërisë, përmes konsultimeve të gjera me shoqërinë civile, të cilat do të ravigëzojnë mënyrat për të reduktuar varfërinë. Ky dokument kombëtar quhet Dokumenti i Strategjisë për Reduktimin e Varfërisë (PRSP) dhe i jep mundësi vendeve të aplikojnë për një reduktim të borxhit nga banka. Udhëzimet gjinore të Strategjisë këshillojnë modele pjesëmarrëse të ndjeshme në lidhje me përkatësinë gjinore në fazën diagnostikuese të varfërisë dhe në zhvillimin e ndërhyrjeve reaguese me bazë gjinore në politika (shih faqen e Internetit të Bankës Botërore <http://www.worldbank.org>). Ata gjithashtu ofrojnë udhëzime për monitorimin pjesëmarrës të treguesve dhe për të dalluar impaktin e diferencuar gjinor të veprimeve të PRSP. Megjithatë, brenda Bankës Botërore, ose shumicës së qeverive kombëtare ende nuk ekziston një mekanizëm përgjegjshmërie, për të siguruar ndjekjen e këtyre udhëzimeve ose të kritereve të tjera të lidhura me përkatësinë gjinore.

Tanzania

Në Tanzani u ndërmorr një analizë gjinore e PRSP nga një grup pune mbi përkatësinë gjinore, që përfshinte përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit të Komunitetit dhe e Çështjeve të Grave. Ata arritën në përfundimin se dokumentit i mungonte analiza gjinore dhe ishte mbështetur mbi të dhëna që nuk ishin të zbërthyer sipas përkatësisë gjinore:

- PRSP-ja nuk kishte marrë parasysh faktin që gratë dhe burrat e përjetojnë varfërinë në mënyra të ndryshme.
- Strategjitë e reduktimit të varfërisë nuk kishin analizuar kontekstet që krijojnë pabarazi, dhe nuk kërkonin të krijojnë strategji të përshtatshme për t'i trajtuar këto, si politika, ligje dhe alokim burimesh.
- Kontributi i grave në ekonominë prodhuese mbetet i padukshëm në këtë analizë. Puna e tyre e papaguar në shtëpi, përgjegjësitë përkuqdesëse, mbushja e ujit dhe furnizimi me dru për zjarr dhe të ardhurat bujqësore, nuk njiheshin si një kontribut ndaj ekonomisë. Marrja parasysh e kontributit të grave do ta lejonte qeverinë të investonte në sektorët ku është përqëndruar puna e tyre.

Grupi i punës sugjeroi zhvillimin e një koleksioni dhe analize sistematike të të dhënave cilësore dhe atyre të zbërthyer sipas përkatësisë gjinore, në nivele të ndryshme sipas prioriteteve, për të zhvilluar strategji për reduktimin e varfërisë, të ndjeshme në lidhje me përkatësinë gjinore.

Kenia

Qendra e Bashkëpunimit për Përkatësinë Gjinore dhe Zhvillimin, një organizatë jofitimpruriëse vullnetare në Kenia, ka punuar për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm duke integruar drejtësinë gjinore në buxhetet dhe politikat ekonomike kombëtare. Qendra ka përdorur PRSP, të kombinuar me modelet pjesëmarrëse për të arritur objektivat e saj; këto përfshijnë demistifikimin dhe demokratizimin e proceseve qeveritare të planifikimit ekonomik dhe të buxhetit, për të lejuar përfshirjen e grave dhe për të ndërgjegjësuar gratë dhe organizatat e grave mbi angazhimin në këto procese, në të gjitha nivelet (Shiverenge, 2000⁵).

Duket qartë se perspektivat e politikave ka shumë të ngjarë të mbeten të painformuara në lidhje me dimensionet gjinore, nëse nuk monitorohen qëllimisht nga një grup i veçantë. Gjithashtu, ekziston nevoja për mekanizma/grupe që të vëzhgojnë vazhdimisht hartimin e politikave sipas një këndvështrimi gjinor, në sektorë të ndryshëm, duke siguruar që proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit të përfshijnë dialogje me grupe të caktuara. Gjithësesi, vendet me borxhe të thella kanë nevojë për akses të shpejtë ndaj uljes së borxhit – karrota që Banka Botërore zgjat për hartimin e suksesshëm të PRSP. Si rrjedhim, shpesh nuk ofrohet koha e nevojshme për analizë gjinore, shqyrtim të të dhënave të zbërthyer gjinore dhe pjesëmarrje domethënëse të publikut, e për më tepër të shoqërisë civile.

⁵Shih Koleksionin e Burimeve Mbështetëse për një përmbledhje të këtij studimi rasti.

Mekanizmat kombëtarë të grave dhe ndikimi i tyre në proceset e planifikimit

Vende si Kili, Mali, Vietnami, Xhamajka dhe Uganda kanë ngritur mekanizmat kombëtarë të grave, për të ndikuar axhendat gjinore në vendet e tyre. Këto mekanizma marrin formën e njësive të advokacisë, që kanë një mandat për të ndikuar proceset e planifikimit në të gjithë sektorët e zhvillimit për çështjet gjinore/të grave. Këto njësi kombëtare janë vendosur në zyrën e kryeministrit ose në ministri të tjera. Ato kanë një mandat për të promovuar vëmendjen ndaj çështjeve gjinore/të grave dhe për t'i dhënë këshilla njësive të ndryshme qeveritare. Shumica e këtyre njësive kanë krijuar një sërë mjetesh të politikave si lista kontrolli për monitorimin gjinor, udhëzime që theksojnë analizën e të dhënave të zbërthyer gjinore, komitete ndërministrorë dhe trainim për ndërgjegjësimin gjinor. Disa vende, si Kili dhe Uganda, kanë zyrtarë (pika fokale) WID në ministri të tjera për takime dhe integrim gjinor. Ndërsa prania e mekanizmave kombëtarë i ka dhënë një profil më të mirë çështjeve gjinore në politika, vazhdojnë të ekzistojnë disa pengesa në ndikimin e politikave:

- Ende ekziston një mungesë qartësie konceptuale në përdorimin e termit përkatësi gjinore. Tendenca e zakonshme është që të kuptohet sikur ju referohet vetëm grave.
- Pjesëmarrja e shoqërisë civile, grupeve të grave dhe OJF-ve në hartimin e politikave ende nuk është e formalizuar. Një nga vendet e pakta që ka bërë disa përpjekje në këtë drejtim është Uganda dhe departamenti i saj WID (Goetz, 1998).
- Pjesëmarrja bëhet më e vështirë nga struktura hierarkike e burokrative, në të cilat janë vendosur mekanizmat kombëtarë të grave dhe problemet logjistike, si një mungesë e kapaciteteve teknike dhe buxheteve.

WID dhe hartimi i politikave në Ugandë

Në Ugandë, WID është përfshirë në konsultime me shoqërinë civile në hartimin e Kushtetutës. U mbajtën seminare mbi aspektë të ndryshme të kushtetutës, si martesë, divorci dhe rregullat që lidhen me punësimin. Ndër pjesëmarrësit ishin përfshirë bujq analfabetë, nëpunës të shërbimit civil të niveleve të ulëta, si infermierë dhe mësues dhe anëtarë të grupeve të grave dhe OJF-ve vendase. Këndvështrimet e grave mbi kushtetutën u raportuan dhe informuan kornizën kushtetuese. Një tjetër rezultat i këtij procesi ishte një politizim më i madh i grave mbi çështjet kushtetuese, ku 30 gra kandiduan për vende në zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese të vitit 1994.

Analiza gjinore e buxhetit

Një iniciativë e kohëve të fundit në vende të ndryshme, vëzhgon impaktin gjinor, duke analizuar proceset buxhetore, si dhe politikat sociale. Analiza gjinore e buxhetit funksionon mbi parimin se politikat e buxhetit janë kyçi për formulimin e programeve dhe se analiza e buxhetit mund të na tregojë nëse impakti i programeve është në përputhje me politikat e shkruara gjinore të vendit. Të dhënat e zbërthyera gjinore përdoren për të kuptuar impaktin e alokimeve buxhetore dhe analiza mund të çojë në rialokimin e buxheteve të programeve dhe të veprojë si një masë barazuese gjinore. Një punë pioniere po bëhet në Afrikën e Jugut dhe analiza gjinore e buxhetit tani po bëhet në shumë vende të tjera si Xhamajka, Uganda, Mozambiku, Tanzania dhe Bolivia.

Iniciativa afrikano-jugore në lidhje me Analizën gjinore të buxhetit

Iniciativa e Buxhetit Gjinor në Afrikën e Jugut bazohet në Kartën e Gruas të vitit 1993 dhe përkthen gjetjet e veta në një renditje konkrete dhe të prioritetuar të buxheteve të tre sektorëve të ndryshëm. Bazuar në këtë analizë, iniciativa lobon dhe bën advokaci për ndryshime në politikat buxhetore, për të siguruar që alokimet e buxhetit do të çojnë në një impakt rishpërndarës gjinor. Buxheti gjinor afrikano-jugor bazohet në aleancën dhe bashkëpunimin unik strategjik mes grupeve me interesa të përbashkëta. Këto grupe përfshijnë parlamentarët, nëpunësit civilë, OJF-të dhe akademikët. Nëpunësit civilë ofrojnë të dhënat, OJF-të kryejnë advokaci dhe kërkime të fokusuar dhe parlamentarët llojnë për ndryshime buxhetore. Kërkuesit fokusohen tek faktet, në vend të argumentave abstraktë teorikë. Ata mbështeten nga parlamentarët, zyrtarët e qeverisë dhe anëtarë të tjerë të OJF-ve që janë tepër të zënë për të bërë vetë kërkime, por që ofrojnë informacion dhe mënyra sesi të kombinohet analiza sektorale, gjinore dhe buxhetore. Lobimi i suksesshëm i këtij rrjeti çuar në fillimin e “Buxhetit Gjinor brenda Qeverisë”, gjë që më tej ka sjellë ndryshime në politikat buxhetore dhe në impakte rishpërndarëse gjinore (Budlendar, 2000; Hamadeh-Banerjee, 2000).

Mësimet e nxjerra nga këto masa

Të dhënat e ndara sipas seksit

Ekzistenca e të dhënave të zbërthyer sipas seksit dhe aftësia për t'i interpretuar ato, dallojnë si elementë të rëndësishëm për t'u përmirësuar përmes metodave pjesëmarrëse.

Shumica e iniciativave rreth mekanizmave kombëtarë të grave tregojnë një mungesë qartësie konceptuale mbi çështjet gjinore dhe nganjëherë fokusohen vetëm tek gratë. Për më tepër, procesit të PRSP shpesh i mungojnë të dhënat e zbërthyer sipas seksit, ndërsa iniciativa PPA e Bankës Botërore bëri vetëm një analizë selektive të të dhënave të gjeneruara, në përputhje me dokumentat dhe tekstet e saj të mëparshme. Në kontrast me këtë, iniciative afrikano-jugore i kushton vëmendje të theksuar “fakteve të zbërthyer sipas seksit”, më shumë sesa argumentave abstrakte teorike.

Kush merr pjesë dhe në çfarë niveli?

Këndvështrimet e aktorëve dhe palëve të ndryshme ndikojnë proceset e politikave dhe rezultatet e tyre. Në veçanti, faktorë kyçë janë ata që marrin pjesë në nivele të ndryshme të kësaj pune. Zhvillimi i politikave të thelluara përmes analizës lokale, ose një analize mikro-makro, është thelbësisht një proces politik. Sa më lart lëviz informacioni, aq më e mundur është që ai do të filtrohet dhe prezantohet në mënyra të ndryshme, për t’iu përshtatur analizave të ndryshme. Shumë faktorë ndikojnë në rezultatin e proceseve të tilla, si:

- Kush e përcakton axhendën
- Kush vendos se kush do të marrë pjesë në takime
- Kush i regjistron të gjitha hapat dhe kontrollon përfundimet
- Kush shkruan, raporton dhe redakton planin
- Kujt i japin llogari/ndaj kujt janë përgjegjës vendimarrësit
- Kush monitoron, nëse vendimarrësit i kanë trajtuar këndvështrimet e ndryshme.

Transparenca dhe përgjegjshmëria në proceset konsultative

Iniciativat e Ugandës dhe Afrikës së Jugut ilustrojnë rëndësinë e transparencës në konsultime në nivele të ndryshme të dialogut dhe veprimeve politike. Procese të tilla të hapura dhe të

përgjegjshme lejojnë përfshirjen e perspektivave shumëfishe në debat, në arenën publike. Ato gjithashtu ofrojnë mekanizma për të trajtuar marrëdhëniet e pushtetit, që janë pjesë e çdo procesi ndërveprues dhe që çon në zgjedhjen e një alternative politikash ndër të tjerat. Transparenca dhe përgjegjshmëria mundëson zhvillimin e rrjeteve dhe lidhjeve mes njerëzve nga komunitetet lokale, ekspertët kombëtare, kërkuesit shkencorë, politikëbërësit dhe burokratët lokalë. Kjo ofron një hapësirë më të madhe për t'i dhënë zënë shqetësimeve individuale, që normalisht do të mbeteshin në kontekstin e tyre social dhe ofron drejtime të reja për ndryshime në politika në të dy këto kontekste.

Decentralizimi dhe veprimi afirmativ: rritja e pjesëmarrjes së grave në trupat dhe proceset politikëbërëse

Organizatrat qeveritare hierarkike shpesh pengojnë mundësitë për pjesëmarrje, dhe në shumë raste ndërveprimet mes anëtarëve të shoqërisë civile dhe qeverive janë të kufizuara. Pra ekziston nevoja për kanale shumë më të mira për angazhimin e shoqërisë civile, decentralizimin dhe veprimet afirmative. Ideja është se veprimet afirmative, decentralizimi dhe edukimi i bazuar tek të drejtat çojnë në thellimin e politikës demokratike. Ndonjëherë supozohet se kjo do të sigurojë pjesëmarrjen e gruas në proceset politike dhe promovon formimin e grupeve të gravë të shoqërisë civile. Disa qeveri kombëtare janë përpjekur të institucionalizojnë barazinë dhe pjesëmarrjen gjinore përmes veprimit afirmativ dhe decentralizimit. OJF-të janë përgjigjur duke filluar trainimin e zyrtarëve të qeverisë dhe trainimin e njerëzve për të drejtat e tyre.

Veprimet afirmative në Filipine

Në vitin 1991, në Filipine hyri në fuqi një kod i qeverisjes vendore, i cili transferoi disa nga përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë bazë tek njësitë e qeverisjes vendore. Pjesëmarrja aktive nga sektori privat, OJF-të dhe organizatat publike nxitet nga këto njësi, përtej strukturave formale të qeverisë. Për shembull, Gratë Demokratike Socialiste të Filipineve angazhohen në bashkëpunim kritik me qeveritë vendore duke trainuar gratë në leadership komunitar.

Eksperienca në Filipine gjithashtu ka treguar se angazhimi i organizatave të grave në mobilizimin e grave për të marrë pjesë në njësitë e qeverisjes vendore, ka çuar në disa arritje në përkujdes. Gjithsesi, ekzistojnë ende disa probleme në çuarjen përpara të fuqizimit të grave përmes këtyre njësive:

Pak gra zënë pozicionet kyçe në qeverisjen vendore, dhe shumica e pozicioneve të zëna nga gratë janë ato që tradicionalisht konsiderohen si punë grash (për shembull përkujdesi shoqëror, punë në bibliotekë, sekretari/mbajtje procesverbalesh dhe kujdesi shëndetësor). Kjo çon në vazhdimësi të stereotipeve gjinore në tregun e punës. Fuqizimi i grave barazohet me mirëqenien ekonomike dhe shërbimet e përkujdesit si shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe ditor, pra çështje si dhuna në familje shpesh nuk raportohen apo kontrollohen (Atienza, 2000).

Trainimi pjesëmarrës gjinor në Lira të Ugandës

Në vitin 1997, në rrethin Lira të Ugandës u zbatua një program për përkatësinë gjinore dhe decentralizimin. Programi fokusohet në diskutimet komunitare mbi përkatësinë

gjinore dhe nevojën për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në leadershipin vendor. Pjesëmarrësit ishin liderë nga këshillat vendorë, klanet, grupet fetare, grupet e grave, të rinj dhe grupe të tjera. Ky program synonte të:

- Promovonte diskutimin e roleve gjinore në nivel familjar dhe komunitar;
- Nxiste mbështetjen komunitare për gratë në leadership;
- Trainonte kandidatë për këshillat vendorë në strategjitë e fushatave dhe të delegonte punën;
- Zhvillonte ndërgjegjësimin se elektorati është i përbërë nga grupe të ndryshme njerëzish, secili me interesat dhe problemet e veta specifike.

Kjo u realizua duke bërë diskutime në grupe të vogla mbi çështjet e mësipërme, duke identifikuar pengesat në pjesëmarrjen politike të grave dhe zgjidhjet e mundshme. U diskutuan rolet gjinore dhe u theksua roli i gruas në sferën prodhuese, si dhe shtëpiake. Diskutimet identifikuan pengesa si:

- Ngarkesa e punës dhe mungesa e transportit për të ndjekur takimet;
- Dyshimet e anëtarëve meshkuj të familjes për ndërveprimin me burra të tjerë në takime;
- Mungesa e respektit për gratë si lidere, nga burrat dhe gratë;
- Anshmëritë ndaj grave të martuara, të divorcuara dhe vejusha si lidere.

Për disa nga çështjet e mësipërme u gjetën zgjidhje. Pengesat si ngarkesa e madhe e punës për shembull, u trajtuan duke ndarë punën për mbushjen e ujit dhe mbledhjen e druve për zjarr dhe me një rritje të përfshirjes së burrave në punët e shtëpisë. Ky program trainimi rriti numrin e kandidateve gra dhe tejkaloi kriterin e përfaqësimit të grave me një të tretën, në këshillat vendorë. Në disa rrethe ato arritën 42 përqind. Kandidatet gra treguan vetëbesim dhe asertivitet, rritën solidaritetin dhe u mbështetën nga liderët e klaneve (Tempelman, 2000).

Veprimet afirmative në Indi

Në zbatim të amendamenteve kushtetuese 73 dhe 74 në Indi, një e treta e vendeve në Gram Panchayats dhe bashki u rezervuan për gratë. Tani, rreth një milion gra kanë hyrë në institucionet politike vendore. Gjithsesi, studimet empirike kanë treguar se gratë që i përkasin klasës elitare përfshihen më shumë në politikën lokale dhe se ato jo domosdoshmërisht përfaqësojnë interesat e grave të varfra. Gjithashtu, është vëzhguar se të paktën në fillim, burrat e grave të zgjedhura kanë ndikim domethënës në drejtimin e panchayats (Nair, 1997; Nanivadekar, 1998; Pai, 1998). Eksperiencat më të fundit në shtete të ndryshme tregojnë se anëtarët femra të panchayat, kur mbështeten nga organizatat dhe OJF-të e grave, fitojnë besim për të ngritur çështjet e shitjes së pijeve alkolike, përdorimit të fondeve të zhvillimit për shkolla, dhe çështjet e higjienës së ujit (Akerkar, 1998). Disa studime gjithashtu sugjerojnë se trainimi i grave në funksionet e panchayat, mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre si anëtare të zgjedhura dhe edukimi në shprehjet politike po i ndihmon ato të marrin pjesë në këtë hapësirë të re politike (Mahi, 1998).

Gjithsesi, ndërsa dhuna, politika e kastës dhe e klasës ende mbizotëron në punën e shumicës së panchayats, pjesëmarrja e grave nuk po ndryshon thelbësisht marrëdhëniet e pushtetit brenda komuniteteve. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e gruas në sistemin politik vendor flet ende për drejtësi gjinore minimale. Buxhetet gjithashtu mbeten një pengesë në ndërmarrjen e aktiviteteve krijuese dhe disa Gram Panchayats janë të nënfinancuara. Një përjashtim i dukshëm është shteti Kerala, ku 40% e buxhetit të shtetit për zhvillimin i është alokuar planifikimin të panchayats për zhvillimin. Këtu, 10% e buxhetit të panchayat është alokuar si “buxhet i grave” dhe përdoret për aktivitete të përkujdesit me gratë në qendër.

Dhe pse këto studime rasti tregojnë përpjekje për të problematizuar politikat përfaqësuese, ende duhen bërë pyetje se kush po përfaqësohet dhe në ç'mënyrë. Kërkesat e grave të varfra jo domosdoshmërisht përfaqësohen, kur gratë nga klasat më të privileguara fitojnë të drejtën e hyrjes në zgjedhjet vendore. Politikat vendore pra mund të konsiderohen si një tjetër fushë beteje, që ofrojnë si mundësi ashtu dhe pengesa për ndryshimet në marrëdhëniet gjinore. Veprimet afirmative në vetvete nuk kanë çuar në ndryshime në strukturat dhe marrëdhëniet shoqërore. Është e nevojshme të trajtohen çështje si e drejta e pronës për gratë, ligjet efektive kundër dhunës dhe ndryshimi i ndarjes seksuale të punës.

Veprimet afirmative dhe decentralizimi do të kenë një ndikim pozitiv në marrëdhëniet gjinore, vetëm nëse ecin krah për krah me një proces reflektimi kritik për cilësinë e pjesëmarrjes politike dhe me një proces trainimi të të drejtave për qytetarët, personelin e institucioneve të zhvillimit dhe punonjësit qeveritarë. Modelet pjesëmarrëse të zhvillimit kanë rolin e tyre në një reflektim të tillë kritik, si dhe për të siguruar se trainimi është i lidhur me çështjen dhe se ekziston aksesimi ndaj tij. Kjo, së bashku me trainimet e ndërgjegjësimit gjinor dhe programet e ngritjes së kapaciteteve, do të kenë një impakt afatgjatë dhe të ruajtur në kohë.

Përfundime

Kombinimi i një “perspektive sociale dhe të marrëdhënieve” me përdorimin e përkatësisë gjinore si një kategori analize, na mundëson të mendojnë mënyra për të ndryshuar marrëdhëniet e pabarabarta shoqërore, të ndikuara përmes përkatësisë gjinore, klasës, kastës dhe moshës.

Është thelbësore të zhvillohen strategji që fokusohen si mbi burrat, ashtu dhe mbi gratë, dhe të punohet me ndryshimet dhe kompleksitetet, që janë pjesë përbërëse e çdo konteksti social. Andrea Cornwall thotë se pushteti dhe mungesa e pushtetit nuk duhet të kuptohet sipas ndryshimeve mes kategorive fikse të identitetit të burrave dhe grave. Modelet dhe metodologjitë pjesëmarrëse duhet të eksplorojnë, analizojnë dhe të punojnë hapur me ndryshimet mes grave dhe grave dhe mes burrave dhe gra të grupeve të ndryshme sociale. Kjo nuk bëhet për të mohuar se në disa raste si dhuna, prona apo të drejtat riprodhuese, mund të ketë interes të përbashkëta mes grave dhe se një përdorim strategjik i kategorisë gra mund të jetë i rëndësishëm politikisht, për të organizuar gratë rreth këtyre çështjeve (Cornwall, 2001).

Metodat pjesëmarrëse potencialisht mund të ndihmojnë të varfërit dhe të marxhinalizuarit të kenë zërin e tyre për të shprehur mënyrën sesi e kuptojnë realitetin e tyre shoqëror dhe të ndikojnë praktikën dhe axhendat e politikave.

Gjithësesi, studimet e rastit të analizuara këtu tregojnë se modelet dhe metodologjitë pjesëmarrëse si teknikat PRA, në vetevete jo domosdoshmërisht lejojnë artikulinimin e zërave të të varfërve dhe grave. Përdorimi i metodologjive pjesëmarrëse në vetvete mund të mos mjaftojë për të prodhuar impakte të drejta dhe mund të ketë madje dhe impakt çfuqizues

mbi gratë dhe grupe të tjera të marxhinalizuara. Metodologjitë pjesëmarrëse atëherë duhet të angazhohen me detyrën politike të ndryshimit të idesë së një komuniteti homogjen. Lehtësimi i organizatave dhe individëve duhet të njohë dhe të angazhohet në mënyrë krijuese me dimensionet e pushtetit që janë pjesë përbërëse e këtyre proceseve.

Është thelbësore të institucionalizohet drejtësia gjinore, si dhe proceset pjesëmarrëse në praktikën e projekteve, programet e zhvillimit dhe formulimin e politikave.

Hapi i parë është njohja e palëve të ndryshme si aktorë në formulimin e politikave/ciklit të projektit. Këta mund të jenë palë kryesore ose komunitetet vendase të grave dhe burrave të ndarë sipas klasës, kastës, etnisë dhe moshës, përfaqësues të organizatave donatore, qeverive kombëtare, OJF-ve dhe organizatave të tjera zbatuese dhe politikëbërës. Kuptimet, të kuptuarit dhe operacionalizimi i “drejtësisë gjinore” në praktikën e projekteve dhe formulimin e politikave janë si rrjedhim në një proces konstant ripërcaktimi dhe riformulimi, teksa palët e ndryshme angazhohen dhe negociojnë me njëra-tjetrën, sipas të kuptuarit të ndryshëm që kanë për drejtësinë gjinore. Është e nevojshme që të trajtohet dhe kuptohet konteksti më i gjerë institucional dhe marrëdhëniet e pushtetit që ndikojnë në pjesëmarrjen e palëve të ndryshme.

Rekomandime të praktikave të mira për të institucionalizuar proceset pjesëmarrëse dhe çështjet gjinore në nivele të ndryshme

Për programet dhe projektet:

Lehtësimi i një kulture të të mësuarit që përqafton dështimet dhe përgjigjet ndaj situatave aktuale përfshin lehtësimin e modeleve të decentralizuara, përkundrajt atyre të centralizuara,

gjë që nxit këndvështrimet e bazës dhe të kuptuarit shumëfish të realitetit. Rekomandimet më specifike përfshijnë:

- Zhvillimin e metodave të punës me ndryshimet si mosha, përbërja shoqërore, klasa dhe statusi martesor për të aftësuar individët të paraqesin realitetet e veta shoqërore. Praktikisht, kjo do të thotë organizimin e praktikave të projekteve dhe proceseve planifikuese në mënyrë të tillë që të marrin parasysh pengesat në kohë të grave të varfra dhe ngarkesën e tyre të punës.
- Nxitjen e burrave, grave dhe grupeve të tjera shoqërore brenda komunitetit të zhvillojnë planet e tyre të veprimit për zbatim, dhe t'i përdorin këto plane për monitorim dhe vlerësim të mëtejshëm.
- Zhvillimin e sistemeve të matjes së performancës së personelit që theksojnë treguesit cilësorë, si promovimi i proceseve të fuqizimit, në krahasim me qëllimet sasiore.
- Trainimin dhe ngritjen e kapaciteteve të lehtësuesve në metodologjitë pjesëmarrëse dhe të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, dhe në modelet me bazë të drejtat dhe të advokacinë.
- Përdorimin e një modeli me bazë të drejtat dhe një modeli ndërgjegjësimi, duke integruar njohuritë dhe veprimin social. Kjo siguron një bazë të fortë për veprim. Gjithashtu bën të mundur që të trajtohen dimensionet më të gjera të varfërisë të përfshira në konceptin e përjashtimit social.

Për të ndikuar në proceset e formulimit të politikave:

- Zhvillimi i njëjësive gjinore brenda qeverive kombëtare, për të nxitur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e bërjes së politikave.
- Përdorimi dhe zhvillimi i metodologjive dhe mjeteve me procese pjesëmarrëse, duke përfshirë metodologjitë PRA, që lehtësojnë informacionin e zberthyer gjinor dhe perspektivat gjinore në nivele të ndryshme të proceseve të formulimit të politikave.

- Në rastin e formulimit të politikave, organizatat lehtësuese (qeveria, institucionet joqeveritare, ose të tjera si ato të Kombeve të Bashkuara ose Banka Botërore), duhet të bëjnë konsultime dhe të angazhohen me aktorë të ndryshëm në shoqërinë civile, veçanërisht me grupet e grave dhe grupe të tjera të marxhinalizuara. Kjo mund të sjellë transparencë në negociimet mes palëve të ndryshme. Kështu, njohuritë e dala në pah dhe perspektivat e shkëmbyera nuk manipulohen dhe zërat e grupeve të marxhinalizuara si gratë e varfra nuk humbin në analizën e të dhënave ose interpretimet selektive.
- Veprimet afirmative dhe decentralizimi i politikëbërjes që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e burrave dhe grave në politikat dhe programet vendore që i prekin ata, është e nevojshme të vendosen përgjatë politikave që aftësojnë gratë të kërkojnë të drejtat e tyre njerëzore në fusha si prona, puna dhe dhuna. Kjo mund të ndihmojë transformimin e marrëdhënieve shoqërore përmes pjesëmarrjes së gruas në politika dhe programe.
- Zhvillimi i programeve të trainimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, për të arritur një cilësi më të mirë të pjesëmarrjes së grave, veçanërisht atyre të varfra, në proceset e vendimarrjes vendore. Është e rëndësishme të mos supozohet se një rritje në numrin e grave që marrin pjesë, së bashku me decentralizimin e politikëbërjes, automatikisht rezulton në përfshirjen e çështjeve gjinore në axhendat e politikave. Gjithashtu mund të jetë e dobishme të përdoren disa nga metodologjitë pjesëmarrëse që nxitin pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme shoqërore në formulimin e programeve vendore, për të siguruar respektimin e prioriteteve dhe interesave të palëve të ndryshme.
- Sigurimi i alokimit të përshtatshëm të buxhetit për programet e ndryshme, i informuar nga objektivat rishpërndarëse gjinore.

Rishikimi i çështjeve gjinore dhe të pjesëmarrjes tregon tre boshllëqe kritike në njohuri

- Ndërsa disa nga studimet e rastit kanë zhvilluar metodologji që nxisin artikulet e ndryshme përtej akteve të ndryshmeve si përkatësia gjinore, mosha dhe klani/kasta, nuk ekzistojnë shume eksperienca që janë marrë njëkohësisht me të gjitha këto akte ndryshimesh në proceset dhe metodologjitë e tyre pjesëmarrëse. Ndërsa botimet e fundit si Miti i Komunitetit (Guijt dhe Shah, 1998), kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në këtë debat, është e qartë që ekziston nevoja për kërkime dhe dokumentacion të mëtejshëm mbi këtë çështje.
- Ekziston një mungesë informacioni, kërkimi shkencor dhe dokumentimi mbi institucionalizimin e ndryshimeve. Materialet më të disponueshme janë raportet mbi programe trainimi dhe impaktin e tyre. Gjithsesi, ndryshimet sociale, dhe veçanërisht ato që lidhen me marrëdhëniet gjinore, ndodhin në një periudhë të gjatë kohe në ciklin e projektit. Ekziston një nevojë për të prekur kompleksitetet e përfshira në institucionalizimin e ndryshimit, duke pasur parasysh praninë e një numri palësh të interesuara. Ndryshimi i marrëdhënieve gjinore përfshin sfidimin e anshmërive të thella personale, qëndrimeve, praktikave dhe strukturave
- Proceset transparente, të hapura dhe të përgjegjshme me konsultime që përfshijnë seksione të gjera të shoqërisë civile dhe grupe të ndryshme shoqërore, kanë një mundësi më të madhe për të ruajtur perspektiva gjinore të bazës, në kontekstin e politikëbërjes. Ende nuk është shumë e qartë sesi duhet të institucionalizohet transparenca dhe përgjegjshmëria në proceset e formulimit të politikave, si përzgjedhja dhe analiza e të dhënave. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që prioritetet e artikuluara nga grupet e marxhinalizuara dhe gratë përmes metodologjive pjesëmarrëse të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të mos humbin.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Përkatësia gjinore dhe pjesëmarrja : raport
përmbledhës/përg. IZELA TAHINI.-Tiranë:
ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM,2005.

52f.;19cm.

ISBN 99943-816-3-6

Tahini,Izela përg.

316.346.2(047.3)

396(047.3)

